



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 40/2011
Prishtinë, më 25.11.2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Fikrim Damka, Sala Berisha - Shala, Lutfi Zharku, Visar Ymeri, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Munguan: Teuta Sahatqija, Berat Buzhala, Hashim Deshishku dhe Ramiz Kelmendi.

Pjesëmarrës të tjerë: Agim Isufi dhe Gurakuq Kastarti-MTI; Ukë Gashi - ZPRK; Ardian Kryeziu, Petrit Gashi dhe Douglas Cruickshank USAID/BEEP dhe Natyra Kasumaj.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe konsulentët e Komisionit, Brikena Hoxha dhe Visar Gjakova.

Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 15.11.2011;
3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve të Projektligjit nr. 04/L-78 për sigurinë e përgjithshme të produkteve;
4. Të ndryshme.

Kryetari, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 15. 11. 2011

Procesverbali i mbledhjes datës 15. 11. 2011 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve të Projektligjit nr. 04/L-78 për sigurinë e përgjithshme të produkteve

Kryetari – Tha se, si kryesuese e grupit të punës është znj. Myzejene Selmani dhe ia dha fjalën për t'i paraqitur propozimamendamentet e Projektligjit nr.04/L-78 për sigurinë e përgjithshme të produkteve.

Myzejene Selmani – Në cilësinë e raportueses së grupit të punës për Projektligjin nr.04/L-78 për sigurinë e përgjithshme të produkteve, paraqiti raportin me propozimamendamente të Projektligjit. Ajo shtoi se për këtë Projektligj, grupi i punës ka realizuar takime dhe është konsultuar me përfaqësuesit e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, projektit USAID/BEEP dhe me Njësinë mbështetëse të Komisionit, kemi përgatitur 21 propozimamendamente.

Vërejtjet në Amendamente

Sala Berisha-Shala - Për amendamentin 1, nuk ka nevojë të ketë amendamente, sepse harmonizimi gjuhësor në gjuhën shqipe dhe angleze, bëhet nga zyra për standardizim e Kuvendit dhe është i panevojshëm.

Komisioni miratoi propozimin e deputetes.

Lutfi Zharku – Kërkoi që të fshihet neni 14 të mbikëqyrja doganore, sepse ky nen krijon pengesa dhe vështirësi të shumta procedurale, sepse kjo fushë rregullohet nga inspektorati i caktuar.

Komisioni miratoi propozimin e deputetit.

Visar Ymeri - Kërkoi disa sqarime prej anëtarëve të grupit të punës për amendamentet tek nenet 15,16,17. Pse janë fshirë?

Myzejene Selmani – Sqaroi se këto nene janë të rregulluara me ligjet në fuqi dhe janë të panevojshëm të përfshihen edhe në këtë ligj, për shkak se po duplikohen gjërat.

Pas debatit të gjerë, Komisioni njëzëri nxori këtë

Konkluzion

1. Miratohet raporti me amendamente i Projektligjit nr.04/L-78 për sigurinë e përgjithshme të produkteve dhe të dërgohet për shqyrtim të mëtutjeshëm në Komisionet e përhershme.

2. Autorizohet Njësia mbështetëse e Komisionit, që të bëjë harmonizimin gjuhësor dhe në spastrimin e ligjit, të evitojë referencat tek nenet e fshira.

4. Të ndryshme

Kryetari – Njoftoi deputetët se ka ardhur nga Ministria për Zhvillim Ekonomik, Strategjia minerare për periudhën 2012- 2025, ku edhe do të organizohet një dëgjim publik në javën e ardhshme. Po ashtu njoftoi se do të organizohet një dëgjim publik në lidhje me monitorimin e Ligjit për shpronësim dhe do të bëhen vizita në terren. Në fund, njoftoi anëtarët e Komisionit për ftesën e Odës Tregtare të Kosovës për një vizitë në Turqi, nga data 4.12. 2011— 7.12.2011.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetari i Komisionit